

## **BISHZ - VAIS - UIAS**

**BASHKIMI I INTELKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR**  
VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELLEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ  
**UNION DES INTELLECTUELS ALBANAIS EN SUISSE**  
UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA

Fabrikstrasse 36 - 3012 Bern Tel. 031 / 302 15 16 Fax 031 / 302 15 16

---

# **PROTOKOLI I MBLEDHJES SË KUVENDIT THEMELUES TË BASHKIMIT TË INTELKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR (BISHZ)**

---

**Vendi:** Salla Trianon, Hotel Schweizerhof në Bernë, Bahnhofplatz 11, 3003 Bernë  
**Data:** E shtunë, 29 nëntor 1997 / 15.00-19.00  
**Protokoli:** Gjuliano Iseini  
**Pjesëmarrës:** Rreth 130  
**Dokumentet shtesë:** Ftesa me rend të ditës; Projekt-Statuti i BISHZ-së; Programi i BISHZ-së; Fletorja për evidencën e pjesëmarrësve; Formulari për regjistrim

---

\*\*\*

*Këshilli inicues i përbërë nga: z. Ahmet Xhigoli, z. Ismet Kuçi, z. Nazmi Jakurti, z. Fehmi Dragidella, z. Feriz Ferizi, z. Sulejmon Jashari, z. Lekë Rrotani, z. Shaqir Shala, në mbledhjen e mbajtur më 5 tetor 1997 mori vendim që Kuvendi i themelimit të Bashkimit të Intelktualëve Shqiptarë në Zvicër të mbahet më 29.11.1997 në ora 15.00 në Hotelin Schweizerhof në Bern. Poashtu u muar qëndrim që përshëndetjet në shqip dhe gjermanisht ta bënë z. Ahmet Xhigoli, ndërsa në frëngjisht nga z. Ismet Kuçi. Poashtu u muar qëndrim që dokumentet shtesë të mbledhjes për të gjithë pjesëmarrësit të jenë: projekt-statuti, programi i punës, fletorja për evidencën e pjesëmarrësve, formulari për anëtarim.*

\*\*\*


### **Rendi i ditës:**

1. Përshëndetja e të pranishmëve
2. Formimi dhe rëndësia e BISHZ-së
3. Miratimi i statutit dhe programit të punës
4. Zgjedhja e kryesisë
5. Të ndryshme

Në fund të punimeve të Kuvendit është ofruar një koktej.

## **1. Përshëndetja e të pranishmëve**

Në Kuvendin themelues merrnin pjesë rreth 130 intelektualë të profesioneve të ndryshme: doktorë dhe magjistra të shkencave natyrore dhe shoqërore, inxhinierë, matematicientë, mjekë, juristë, ekonomistë, politologë, sociologë, filologë, arkeologë, profesorë, pedagogë, gazetarë, piktorë, shkrimtarë, kameranë, designerë, studentë, PC-Specialistë, punëtorë. Në mesin e tyre ndodheshin mysafirët, z. Vladimir Thanati, ambasador i Republikës së



Shqipërisë në Bernë, z. Andi Gjonej, ambasador i Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së në Gjenevë, z. Daim Iljazi, konzull i IRJM-së në Bernë, prof. dr. Kristian Zindel, prof. Astrit Leka, si dhe të ftuar të tjerë.

Përshëndetjen e të pranishmëve në shqip dhe gjermanisht e bëri z. A. Xhigoli, ndërkaq në frëngjisht z. Ismet Kuçi, të cilët falenderuan të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë Kuvend solemn.

## 2. Formimi dhe rëndësia e BISHZ-së

Për rolin, rëndësinë e formimit, si dhe qëllimet e BISHZ-së në të ardhmen foli z. Xhigoli. Ai tha se veprimtaria BISHZ-së do të shtrihet në mbarë shtetin zviceran. Pastaj i njoftoi të pranishmit se janë përpiluar statuti dhe programi i BISHZ-së të përkthyer në gjuhën gjermane dhe frënge. Në vazhdim z. Xhigoli, tha se BISHZ është i hapur për të gjithë. Ai do të organizojë veprimtarinë e vet përmes tribunave, realizimin e projekteve nga fusha të ndryshme, përgatitjen profesionale etj. Gjithashtu z. Xhigoli paraqiti një rezymë të shkurtër në gjuhën gjermane, lidhur me rolin, rëndësinë dhe qëllimin e formimit të BISHZ-së.

Pastaj fjalën e morrën: z. Vladimir Thanati, ambasador i Republikës së Shqipërisë në Bern; Andi Gjonej, ambasador i Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë OKB-së në Gjenevë; z. Daim Iljazi, konzull i IRJM-së në Bernë; z. Kadri Çenko, zëvendëskryeredaktor i gazetës "Republika"; z. Astrit Leka, profesor; z. Kristian Zindel, prof. dr. i arkeologjisë në Universitetin e Zürich-ut. Të gjithë diskutuesit e vlersuan shumë këtë nismë për krijimin e kësaj Shoqate.

## 3. Miratimi i statutit dhe programit të punës


Z. Nazmi Jakurti filloi të lexojë para të pranishmëve statutin. Pas përfundimit të leximit të statutit filloi debati lidhur me nenet dhe pikat e tij. Në diskutim u inkuadruan këta kandidatë: z. Nikë Gjeloshi, mr. i Shkencave politike; z. Ali Sylejmani, jurist; z. Astrit Leka, profesor; z. Shqip Beqiri, shkrimtar; z. Ragip Gashi, avokat; z. Gjuliano Iseini, filolog; z. Zeki Beqiraj, jurist; Ruzhdije Murati, inxhinierë.

Si konkluzion u vendos që statuti i prezentuar nga këshilli inicues në tërësi të miratohet, kurse për vërejtjet apo plotësimet e ndryshme që kanë të bëjnë me nenet apo pikat e statutit, ato të dërgohen në adresë të kryesisë së re.

Pas miratimit të statutit filloi leximi i programit të punës nga ana e z. Jakurti. Më pas u hap diskutimi lidhur me projektet dhe seksionet. Për këtë pikë diskutuan: z. Jetullah Haliti, akademik; z. Shqip Beqiri, shkrimtar, znj. Luljeta Nevzati, mjeke. Edhe për programin e propozuar nga këshilli inicues u vendos që vërejtjet apo plotësimet e ndryshme të tij, të dërgohen në adresë të kryesisë së re.

## 4. Zgjedhja e Kryesisë

Në pikën e katërt të rendit të ditës u dhanë disa propozime. Në fund me shumicë votash u vendos që kryesia e re të përbëhet prej 15 anëtarëve.



## **BISHZ - VAIS - UIAS**

**BASHKIMI I INTELEKTUALËVE SHQIPTARË NË ZVICËR**  
**VEREINIGUNG DER ALBANISCHEN INTELEKTUELLEN IN DER SCHWEIZ**  
**UNION DES INTELECTUELS ALBANAIS EN SUISSE**  
**UNIONE INTELLETTUALI ALBANESI IN SVIZZERA**

Fabrikstrasse 36 - 3012 Bern Tel. 031 / 302 15 16 Fax 031 / 302 15 16

---

Anëtarët e zgjedhur në këtë kuvend janë: z. Ahmet Xhigoli, z. Nazmi Jakurti, z. Gjuliano Iseini, znj. Florije Rexhaj, z. Ismet Kuçi, z. Shaqir Shala, z. Jetullah Haliti, znj. Luljeta Nevzati, z. Ali Sylejmani, znj. Lolita Poda, z. Kadri Çenko, z. Arif Elezi, z. Sefejdin Haxhosaj, z. Enver Pula, z. Feriz Ferizi.

Anëtarë nderi në këtë mbledhje u propozuan: Prof. Astrit Leka, znj. Nicole Bovard nga Gjeneva dhe z. Gilbert Gardes nga Franca.

Pas zgjedhjes së kryesisë së re, anëtarët e saj zgjodhën prof.dr. Ahmet Xhigoli, kryetar, Nazmi Jakurti, nënkryetar, Gjuliano Iseini, sekretar dhe Florije Rexhaj arkëtare.

### **5. Të ndryshme**

Në fund të punimeve të Kuvendit të BISHZ-së, këshilli inicues organizoi një koktej për të pranishmit.

*Mbledhja e Kuvendit zgjati prej orës 15:00 deri në ora 19:00.*

Sekretari i BISHZ-së

Gjuliano Iseini, Dipl. Phil.